

Mirë të dish

Hapat e parë

Oraret e punës / ditët festive

Titulli i qëndrimit dhe marrja e nënshtetësisë

Sigurimi privat i përgjegjësisë ndaj palëve të treta

Alkooli / duhani / droga

Shtazët shtëpiake

Bashkëjetesa në Zvicër

Hapat e parë

Ju erdhët tani me shtëpi në Kantonin Basel-Stadt? Atëherë ju duhet të lajmëroheni brenda 14 ditëve tek zyra e regjistrimit civil. Gjatë lajmërimit personal në zyrën e regjistrimit civil, personat, që sapo erdhën me shtëpi, marrin pjesë në një bisedë individuale të mirëseardhjes.

Regjistrimi zyrtar

Të gjithë personat, që vijnë për herë të parë me shtëpi në Kantonin Basel-Stadt, duhet të lajmërohen brenda 14 ditëve tek zyra e regjistrimit civil në vendbanimin e tyre (Basel, Riehen ose Bettingen).

Ju jeni nga Zvicra ose ju jeni nga një shtet i BE-së ose nga një shtet EFTA:

Ju mund të lajmëroheni ose me shkrim, me E-Umzug CH ose personalisht në zyrën e regjistrimit civil Basel-Stadt, në Riehen ose Bettingen.

Ju nuk jeni nga një shtet i BE-së ose nga një shtet EFTA:

Ju lutemi të vini në zyrën e regjistrimit civil (Einwohneramt) në qendrën e klientëve Spiegelhof. Atje duhet të regjistrujmë të dhënat tuaja biometrike. Për regjistrimin duhet të paguani një taks.

Kjo është adresa:

Kundenzentrum Spiegelhof

Spiegelgasse 6

4001 Basel

Tel. 061 267 70 60

Çfarë ju duhet për regjistrimin?

Ju lutemi të informoheni gjerësisht më përpara, se çfarë dokumentesh duhet të merrni me vete.

Dokumentet duhet të jenë në gjermanisht, frëngjisht, italisht ose anglisht.

Këto dokumente ju duhen me patjetër:

- Formular regjistrimi (Anmeldeformular). Ju duhet ta plotësoni formularin e regjistrimit më përpara.
- Fotokopje me ngjyra e pasaportës suaj të vlefshme ose të kartës suaj të vlefshme të identitetit (për EU/EFTA)
- Fotokopje e kontratës suaj me qira ose e kartës suaj të identitetit për banesën

Ndoshta edhe këto dokumente ju duhen:

- Viza
- Kontrata e punës

- Deklarata mbi evidencën penale
- Certifikata e martesës
- mundet edhe të tjera

Nëse shpërnguleni brenda kantonit ose largoheni me shtëpi nga kantoni Basel-Stadt, ju gjithashtu duhet të lajmëroheni tek zyra e regjistrimit civil.

Ju nuk jeni nga një shtet i BE-së ose nga një shtet EFTA, por tashme jetoni në Zvicër: Në rastin e një ndërrimi të kantonit, kërkoni para ardhjes suaj me shtëpi në kantonin Basel-Stadt miratimin e entit për migrimin. Regjistrimi është i mundur vetëm pas këtij hapi.

Biseda e mirëseardhjes

Kur shkoni për lajmërimin tek zyra e regjistrimit civil, ka një bisedë personale. Ne ju përshëndesim, u përgjigjemi pyetjeve tuaja dhe ju informojmë rreth jetesës në Basel.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/mire-me-dit/hapat-e-pare

Oraret e punës / ditët festive

Në Zvicër shumica e dyqaneve janë të mbyllura në ditën e diel.
Përrjashtim bëjnë dyqanet në stacionet e trenit ose në pikat e karburantit. Ditët festive janë të rregulluara me ligje kantonale.

Ditët festive

Festat zyrtare janë të rregulluara në ligjin mbi punën dhe ligjërisht kanë të njëjtin rang si ditët e diela. Data një gusht (dita festive nacionale) është festë zyrtare në të gjithë Zvicrën, që është e përcaktuar me ligj. Gjithashtu çdo kanton mundet të përcaktojë edhe festa të tjera zyrtare. Në kantonin Basel-Stadt këto ditë janë festa zyrtare: Viti i ri (1 janar), e premtja e zeze (e premtja para pashkëve), pashkët, dita e punës (1 maj), ngritja në qiell (e enjte 40 ditë pas të dielës së pashkëve), festa e rrëshajave, festa nacionale (1. gusht), Krishtlindjet (25 dhjetor), dita e Stefanit (26 dhjetor).

Oraret e punës në dyqane

Oraret e punës në dyqanet janë kantonalisht të ndryshme. Në kantonin Basel-Stadt dyqanet lejohen të hapen të hënën deri të premten nga ora 6:00 deri në orën 20:00. Sado, oraret mund të ndryshojnë në varësi të dyqanit dhe mund të jenë më të shkurtra. Të shtunën shumica e shitoreve mbyllet më herët se përgjatë javës; shpesh herë në orën 18:00. Të dielën shumica e dyqaneve është e mbyllur. Përrjashtim bëjnë dyqanet në stacionet e trenave, në pikat e karburantit ose dyqane lagjesh, që normalisht janë të hapura 7 ditë dhe në të shumtën e rasteve hapen më herët dhe mbyllet më vonë se të tjerat.

Orari i punës në administratën publike

Administrata kantonale normalisht është e hapur prej të hënës deri të premten nga ora 8:00 deri 12.00 dhe nga ora 14.00 deri 17.00. Disa zyra hapen pasdite tashme prej orës 13:30 apo mund të kontaktohen më gjatë me telefon. Rekomandohet të njoftoheni më parë përrmes internetit apo telefonit për orarin e punës së sporteleve.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/mire-me-dit/orari-i-punes--ditet-festive

Titulli i qëndrimit dhe marrja e nënshtetësisë

Për të banuar më gjatë në Zvicër apo për të punuar këtu nevojitet një leje. Ka një dallim midis lejeve të ndryshme të qëndrimit dhe lejes për vendqëndrim pa kufizim.

Llojet e lejës

Ai që gjatë qëndrimit të tij në Zvicër punon apo qëndron më shumë se tre muaj, ka nevojë për një leje qëndrimi. Kjo lëshohet nga zyra kantonale për migrimin (Migrationsamt). Ka dallim midis lejeve të shkurtra të qëndrimit (deri 1 vit), lejeve të qëndrimit (të kufizuara) dhe lejeve për vendqëndrim pa kufizim (pa afat) si dhe lejeve të udhëtarëve ndërkuftarë.

- Leja e shkurtër e qëndrimit (L): Kjo leje është për personat, të cilët për një kohë të caktuar (më së shumti një vit) jetojnë në Zvicër për një arsye të caktuar qëndrimi. Shumica e nënshtetaseve dhe nënshtetasve të shteteve të BE-së/EFTA, që mund të parashtrajnë vërtetim për një marrëdhënie pune nga 3 muaj deri në një vit (kontratë pune), kanë të drejtën e kësaj leje.
- Leja e qëndrimit (B): Kjo leje është për personat, të cilët qëndrojnë për kohë më të gjatë në Zvicër. Shumica e nënshtetaseve dhe nënshtetasve të shteteve të BE-së/EFTA kanë një të drejtë për këtë leje, nëse mund të parashtrajnë vërtetim, që ata punojnë për shumë se një vit në Zvicër (kontratë pune). Leja e qëndrimit u ndahet nënshtetaseve dhe nënshtetasve të shteteve të BE-së/EFTA për pesë vite. Për personat nga shtetet e tjera vlefshmëria e lejes është një vit. Pastaj duhet të parashtrohet kërkesa për zgjatjen e lejes. Për zgjatjen e lejes së këtyre personave mund të vendosen kushte, p.sh. ndjekja e në një kursi të gjuhës gjermane. Ata nuk kanë një të drejtë për zgjatjen e lejes. Arsyet, që mund të ndikonin kundër një zgjatjeje, janë p.sh. vepra penale ose varësia nga ndihma sociale. Leja e qëndrimit shuhet, nëse personi qëndron jashtë vendit për më shumë se gjashtë muaj pa ndërprerje. Edhe refugjatët të pranuar e marrin lejen e qëndrimit B.
- Leja për vendqëndrim pa kufizim (C): Kjo leje mund të merret pas 5 apo 10 vitesh qëndrim në Zvicër. Edhe këto vlejné kushte të ndryshme për persona nga shtetet të BE-së/EFTA dhe nga shtetet e treta. Në rastin e shpërnguljes jashtë vendit, leja për vendqëndrim pa kufizim mund të mbajë vlefshmërinë për maksimalisht katër vjet në kushte të caktuara. Për këtë duhet të parashtrohet një kërkesë në zyrën për migrimin.
- Pranimi i përkohshëm (F): Këtë leje e marrin kërkuesit e azilit, të cilët marrin njohjen si refugjatë, mirëpo pranohen përkohësisht. Leja duhet të rinovohet çdo vit.

Letërnjoftimi për të huaj

Të huajat dhe të huajt, që banojnë në Zvicër, marrin një letërnjoftim për të huaj (Ausländerausweis). Lloji i letërnjoftimit varet nga kriteret të ndryshme. Personat, që shpërngulen nga jashtë, marrin një letërnjoftim biometrik në formatin i një karte çeku. Për këtë, gjatë regjistrimit merren shenjat e gishtave dhe një fotografi. Nëse letërnjoftimi vidhet apo humbet, kjo duhet të lajmërohet menjëherë në polici. Me lajmërimin e humbjes të lëshuar nga policia dhe me një fotokopje të pasaportës nga vendi i origjinës ose të kartës së identitetit (për BE-në/EFTA) mund të porosisni një letërnjoftim të ri tek zyra për migrimin (Migrationsamt).

Zgjatja e vlefshmërisë

Në varësi të llojit të statusit të qëndrimit dhe të nënshtetësisë, vlefshmëria e lejes së qëndrimit duhet të zgjatet në distanca të ndryshme. Nëse një zgjatje është e nevojshme, ju merrni një formular (Verfallsanzeige). Ky formular duhet të plotësohet, të konfirmohet nga punëdhënësi dhe më pas t'i dërgohet zyrës për migrimin (Migrationsamt) së bashku me një kopje të pasaportës të shtetit të origjinës ose kartës së identitetit (për BE-në/EFTA). Për pyetje zyra për migrimin jep informacione.

Marrja e rregullt e nënshtetësisë

Kushdo, që ka jetuar në Zvicër për dhjetë vjet, mund të aplikojë për një leje për marrjen e nënshtetësisë së konfederatës. Vitet e kaluara në Zvicër nga mosha 8 deri në 18 vjeç numërohen dyfish. Parakushte të rëndësishme për marrjen e nënshtetësisë janë, që ju të përmbushni periudhën e vendqëndrimit, që ju të zotoni gjuhën, që jeni të integruar dhe të mos keni borxhe ose evidenca penale.

Marrja e nënshtetësisë me lehtësira

Nën kushte të caktuara ligjore, marrja e nënshtetësisë me lehtësira është për bashkëshortët e huaj të shtetasve zviceranë dhe për pasardhësit e një prindi zviceran. Në rastin e marrjes së nënshtetësisë me lehtësira, është vetëm konfederata ajo që vendos rreth marrjes së nënshtetësisë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/mire-me-dit/titulli-i-qendrimit

Sigurimi privat i përgjegjësisë ndaj palëve të treta

Çdo person i rritur bën mirë të lidhë një kontratë për sigurim privat të përgjegjësisë ndaj palëve të treta. Ky i merr përsipër shpenzimet, kur i siguruari pa dashje i shkakton dëm dikujt.

Përgjegjësia personale ndaj palëve të treta

Kur dikush lëndon një person tjetër apo dëmton një send, që i takon një personi tjetër, ai mban përgjegjësinë financiare për këtë veprim. Kjo vlen edhe atëherë, kur dëmi nuk është shkaktuar me qëllim. Shpenzimet mund të jenë shumë të larta. Kur dikush për shembull lëndon dike gjatë ngasjes së skive, dëmi mund të shkojë në qindra mijëra franga.

Sigurimi privat i përgjegjësisë ndaj palëve të treta

Për mos hyrë në vështirësi financiare në rastin e një dëmi, nevojitet një sigurim privat i përgjegjësisë ndaj palëve të treta (Privathaftpflichtversicherung). Ky ofrohet prej shumicës e kompanive private të sigurimit. Sigurimet private të përgjegjësisë ndaj palëve të treta shpesh mund të lidhen bashkërisht për të gjithë personat, që jetojnë bashkë në një njësi shtëpiake. Ky sigurim nuk është i obligueshëm, por rekomandohet me patjetër.

Shërbimet e sigurimit

Sigurimi privat i përgjegjësisë ndaj palëve të treta i mbulon dëmet materiale dhe dëmet në persona, të cilat një person i siguruar i ka shkakton një tjetri. Këtu hyjnë për shembull shpenzimet për riparim, shpenzimet për shërim, zhdëmtimet për humbje rroge apo para për dhimbjet e shkaktuara. Sigurimi privat i përgjegjësisë ndaj palëve të treta i mbulon edhe shpenzimet dhe dëmet, të cilat i shkaktojnë shtazët e caktuara shtëpiake. Sigurimi nuk paguan për dëmet, që dikush i shkakton personave, me të cilët ai jeton së bashku në njësinë shtëpiake. Nuk mbulohen edhe shpenzimet, që dikush i shkakton me qëllim apo nga pakujdesia e rënde.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/mire-me-dit/sigurimie-private-me-detyrim-zhdemtimi

Alkooli / duhani / droga

Kush mban, konsumon apo shet droga, kryen një vepër penale. Për shitjen e alkoolit dhe të duhanit ekzistojnë kufij moshe.

Droga

Mbajtja, shitja apo konsumimi i drogave ilegale është vepër penale. Kjo vlen edhe për sasi të vogla. Cilat substanca janë ilegale, kjo është e rregulluar në ligjin për lëndë narkotike (Betäubungsmittelgesetz). Shitja e drogës në mënyrë profesionale ndëshkohet me dënime të larta.

Alkooli dhe duhani

Për shitjen e alkoolit dhe duhanit ka kufizime moshe. Në kantonin Basel-Stadt, duhani dhe pijet alkoolike nuk lejohen t'u shiten të rinjve nën 16 vjeç. Për pije të caktuara alkoolike siç janë pijet e forta alkoolike, kufiri në moshë qëndron te 18 vjeç.

Ndalimi i pirjes së duhanit

Ndalimi i pirjes të duhanit në Zvicër është i rregulluar ndryshe në varësi të kantonit. Kantonin Basel-Stadt mbështetet në ligjin e konfederatës për mbrojtjen nga pirja pasive e duhanit dhe në ligjin kantonial i hotelierisë. Ndalim i pirjes të duhanit vlen në:

- hapësirat e mbyllura me qasje publike (spitalet, administratat, shkollat, muzetë, kinema, teatër, tren, autobusë, shitore, dhe qendra tregtare).
- Hapësirat, në të cilat shumë persona e kanë vendin e tyre të punës.

Se a është e lejuar të pihet duhan në restorant, varet nga madhësia e restorantit. Në disa restorante ka dhoma të ndara për pirjen e duhanit.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/mire-me-dit/alkooli--duhani--droga

Shtazët shtëpiake

Kush mban shtazë shtëpiake, duhet t'u përmbahet rregullave të ndryshme. Kështu disa lloje të shtazëve nuk lejohen të mbahen në çdo banesë. Qentë duhet të regjistrohen tek kantoni.

Mbajtja e shtazëve shtëpiake

Kush jeton në një banesë me qira, në çdo rast lejohet të mbajë kafshë të vogla, si derra Indie, brejtës, kanarina apo peshq. Mirëpo mund të jetë, që mbajtja e kafshëve më të mëdha (edhe macet apo qentë e vegjël) janë të ndaluar në kontratën e qirasë. Edhe shtazët, që shkaktojnë zhurmë apo janë të rrezikshme, mundet t'i ndalojë qiradhënësi ose qiradhënësja. Përveç kësaj, mbajtëset dhe mbajtësit e shtazëve duhet ta respektojnë ligjin për mbrojtjen e kafshëve. Nuk lejohet për shembull, që nga species të caktuara të mbahet një shtazë e vetme (p.sh. lepujt e butë). Po ashtu, madhësia e kafazit dhe pajisja e tij janë të përcaktuara. Shumë shtazë (shtazë ekzotike) nuk lejohen fare të sillen në Zvicër. Për disa të tjera nevojitet një leje speciale nga autoriteti veterinar.

Qentë

Në kantonin e Basel-Stadt ka një ligj të posaçëm për qentë. Aty është e përcaktuar, se çfarë detyrash kanë mbajtëset dhe mbajtësit e qenve. Më shumë informacione mund të japë veterineri apo veterinerja.

- Të gjithë qentë në Zvicër duhet të shënjohe me një mikroçip dhe të regjistrohen në një bazë të dhënash. Qeni merr një letërnjoftim qeni (format i kartës për kredi). Ky nuk është identik me letërnjoftimin shtëpiak për shtazë, i cili nevojitet, nëse dikush dëshiron të udhëtojë me shtazën në vendet e unionit evropian.
- Qentë duhet të regjistrohen tek kantoni. Ka një formular onlajn për këtë punë. Çdo vit kërkohen tarifa. Duhet të lidhet një kontratë për sigurim të detyrueshëm të përgjegjësisë ndaj palëve të treta (Haftpflichtversicherung) për mbajtjen e çdo qeni.
- Të gjithë mbajtësit dhe mbajtëset e qenve duhet ta mbledhin dhe ta heqin jashtëqitjen e qenit të tyre. Kush nuk e bën këtë punë, mund të marrë një dënim.
- Për disa raca qensh nevojitet një leje e posaçme (p.sh. Pitbull apo Rottweiler).
- Ndalohet në përgjithësi hyrja e qenve në parqet e qytetit dhe në kënd lojërësive të fëmijëve. Në hartën onlajn "Mapserver" të kantonit janë të shënuar zonat për lëvizje të lirë të qenve si dhe vende për banjë të qenve.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/mire-me-dit/shtazet-shtepiake

Bashkëjetesa në Zvicër

Secili vend ka të karakteristikat e veta kulturore. Kështu ka edhe në Zvicër mënyra të caktuara e sjelljes, të cilat duhet t`i njihni.

Kultura të ndryshme

Në Zvicër ekzistojnë kultura dhe mentalitete të ndryshme. Arsyeja për këtë qëndron edhe në katër gjuhët zyrtare. Diçka, që është normale në pjesën gjermane të Zvicrës, mund të jetë totalisht ndryshe në pjesën franceze të Zvicrës. Mund të ketë edhe ndryshime të mëdha midis qytetit dhe fshatit. Sado ka tradita, që janë njësoj kudo në Zvicër.

Përshëndetjet

Kështu përshëndetemi në Zvicër: Zakonisht japim dorën dhe vështrojmë njëri-tjetrit në sy. Gjithashtu burrat dhe gratë vështrojnë njëri-tjetrit në sy. Në Basel themi "Griezi".

Kur njerëzit njihen shumë mirë, ata thonë edhe "Sali" ose "Hoi". Në fshat njerëzit përshëndeten në rrugë, edhe kur nuk njihen.

Në Zvicër kurtuazia është diçka e rëndësishme. Prandaj themi shpesh "faleminderit" dhe "ju lutem". Për shembull në shitore ose në restorant themi disa herë "faleminderit" dhe "ju lutem".

Përpikëria

Në Zvicër, përpikëria është shumë e rëndësishme, posaçërisht në punë. Nëse vonoheni më shumë se 5 minuta, ju lutemi ta lajmëroni më kohë. Ju doni të takoni dikë? Atëherë pajtohuni më parë për një termin.

Komunikimi indirekt

Në Zvicër zakonisht nuk shprehim kritikë drejtpërsëdrejti. Shpesh dëftojmë vetëm me një shenjë. Megjithatë nisemi nga mendimi, që njeriu tjetër e kupton kritikën. Nëse ju ende nuk e zotoni mirë gjermanishten, kjo është posaçërisht e vështirë për ju.

Veç kësaj nganjëherë u shmangemi konflikteve. Komshinjtë tuaj për shembull ndihen të bezdisur? Atëherë ndoshta nuk vijnë tek ju personalisht, por ju shkruajnë një letër. Ju nuk jeni të sigurt, nëse e keni kuptuar tamam? Atëherë më mirë pyesni edhe një herë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/mire-me-dit/bashkejetesa-ne-zvicer